

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AGRO-INTERNATIONAL-COMPANY" SHPK**

Sot me daten 12/05/2023 (dymijë e njëzet e tre ), unë ortaku themelues :

- **1 Znj. Engjëllushe Baroni**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15 Maj 1969, lindur në Shqipëri dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. G95515098M

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* " AGRO-INTERNATIONAL-COMPANY" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " AGRO-INTERNATIONAL-COMPANY" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Lushnjë; Rruga Kadri Qystri,me nr pasurie 6/11 , zona kadastrale 8571

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Import ,eksport,mbjellje të produkteve bujqësore ,agjensi punësimi të huaj dhe vendas,kryerjen e procedurave ligjore për agjensinë e punësimit. Ushtrimin e te gjitha aktiviteteve qe synojne kultivimin e tokes, pylltarine, mbareshtimin e bagetive, cdo aktivitet tjeter te lidhur me prodhimin, perpunimin, trajtimin, konservimin,ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqesore, dhe cdo aktivitet tjeter te lidhur dhe te ngjashem me bujqesine; ushtrimi i aktiviteteve ne agroturizem. Tregtia me shumice dhe pakice e frutave dhe perimeve dhe produkteve ushqimore ne pergjithesi ,prodhimin dhe tregtimin e produkteve tipike ushqimore, perpunimi, prodhimi, paketimi,shitja dhe shperndarja e produkteve ushqimore ne pergjithesi, tregtia me pakice e lendeve ushqyese dhe prodhimin e lendeve te para ushqimore per t'u shitur me pakice, tregtia me pakice dhe shumice e lendeve ushqimore.Tregtia me pakice dhe shumice e bimeve dhe luleve, farave,plehrave, vazove, artikujve dhe pajisjeve te kopshtarise,artikujve dhe pajisjeve per bujqesi dhe blegtori dhe cdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**



Kapitali themeltar i shoqërisë " AGRO-INTERNATIONAL-COMPANY" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon:

**1. Engjëllushe Baroni zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

**NENI 5**

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

**NENI 6**

**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj. Engjëllushe Baroni**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 8**

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**

**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Lushnje për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**" AGRO-INTERNATIONAL-COMPANY" SH.P.K**  
**ENGJËLLUSHE BARONI**

Engjellushe Baroni

